

STRATEGJITË E SHTYPJES DHE REZISTENCA E KLERIT KATOLIK NË SHQIPËRI GJATË REGJIMIT KOMUNIST (1944-1990)

1. Prof. Dr. Nertila Haxhija Ljarja

USH "Luigj Gurakuqi", Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Departamenti i Historisë

2. Prof. Asoc. Dr. Eranda Halluni

USH "Luigj Gurakuqi", Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Departamenti i Mësuesisë

Abstrakt

Ky punim analizon politikën sistematike të persekutimit ndaj klerit katolik në Shqipëri, gjatë regjimit komunist, duke zbërthyer fazat kryesore të shtypjes dhe mënyrat sesi kleri katolik u bë synim për shkak të ndikimit të tij intelektual, kulturor dhe lidhjeve me Perëndimin. Qëllimi i këtij studimi është të kuptojë dhe dokumentojë mekanizmat e shtypjes dhe rezistencës, si dhe të evidentojë ndikimin e këtij persekutimi mbi jetën fetare dhe shoqërore. Nëpërmjet një analize historike të bazuar në dokumente arkivore, materiale të botuara dhe dëshmi të kohës, studiohen mënyrat e përdorura nga regjimi për të eliminuar klerin katolik, duke përfshirë akuzat e rreme, ekzekutimet, burgimet, torturat dhe përpjekjet për të shpëputur Kishën Katolike nga autoriteti i Vatikanit. Punimi nxjerr në pah kontrastin midis brutalitetit të shtypjes shtetërore dhe rezistencës së fshehtë të besimtarëve dhe klerit, të cilët ruajtën besimin edhe në kushtet më të vështira. Përmes këtij studimi argumentohet se pavarësisht nga shkatërrimi i institucioneve fetare, identiteti katolik mbijetoi si një forcë e padukshme por e qëndrueshme, duke kontribuar në rilindjen e tij pas vitit 1990.

Fjalë kyçe: *persekutim fetar, Kisha Katolike, regjimi komunist në Shqipëri, Revolucioni Kulturor, ateizëm shtetëror, rezistencë e fshehtë.*

Hyrje

Persekutimi i Kishës Katolike në Shqipëri, gjatë periudhës komuniste, përbën një kapitull të dhimbshëm të shkatërrimit të jetës shpirtërore dhe kulturore të vendit. Regjimi totalitar, i udhëhequr nga Enver Hoxha, e perceptonte fenë si kërcënim ndaj ideologjisë marksiste-leniniste dhe për këtë arsye synoi të eliminonte çdo ndikim të jashtëm dhe çdo formë të autonomisë intelektuale dhe morale të klerit. Goditjet ndaj kishës dhe klerit katolik u manifestuan në një kombinim të ekzekutimeve, burgimeve, torturave, internimeve dhe përpjekjeve për ta shpëputur Kishën nga autoriteti i Vatikanit. Ky punim shqyrton këtë politikë sistematike shtetërore, duke analizuar mënyrat sesi regjimi tentoi të dobësonte ndikimin e klerit dhe të shkatërronte institucionet fetare, si dhe mënyrën sesi besimtarët dhe kleri ruajtën një rezistencë të fshehtë, përmes së cilës identiteti katolik mbijetoi dhe përgatiti terrenin për ringjalljen e jetës fetare në dekadat pasardhëse.

Goditjet që u bënë ndaj kishës dhe klerit katolik.

Historia e Kishës Katolike në Shqipëri, gjatë viteve 1944–1990, përfaqëson një rrëfim të dhimbshëm të shkatërrimit të një bote të tërë shpirtërore dhe kulturore. Me ardhjen e regjimit totalitar komunist, i cili në të gjithë bllokun e Lindjes e konsideronte fenë si një element të padëshirueshëm në ndërtimin e shoqërisë së re, kleri u përndoq, institucionet fetare u mbyllën dhe trashëgimia e ndërtuar për shekuj me radhë u vë në shënjestër. Përplasja midis Kishës dhe shtetit totalitar ishte e pashmangshme, pasi doktrina marksiste-leniniste, në kryqëzatën e saj për një shoqëri pa klasa, parashikonte një “*dorë korrigjuese*”, jo vetëm kundër pabarazive ekonomike, por edhe të gjitha ndryshimeve fetare. Megjithëse persekutimi u përjetua në të gjithë bllokun komunist, në Shqipëri ai arriti përmasa veçanërisht brutale. Nën drejtimin e Enver Hoxhës (1944-1985), Shqipëria zbatoi një nga variantet më të rrepta të marksizëm-leninizmit, duke u identifikuar *de facto* si një ateizëm shtetëror. Regjimi, në përputhje me metodat e dhunshme të zotërimit të pushtetit dhe nën influencën e tutelës së huaj (jugosllave, ruse e kineze), synoi të eliminojë çdo personalitet fizik dhe moral që i paraqiste rezistencë, qoftë edhe ideologjike. Paradoksi qëndron në atë se regjimi më i ashpër dhe më doktrinar në të gjitha vendet e Evropës Lindore do të zbatohet në vendin më të vogël dhe më të varfër të këtij kampi, në Shqipëri.¹

Pas fitores së luftës, të realizuar në vitin 1944, komunistët shqiptarë ndoqën rrugën e dobësimit gradual dhe të shkatërrimit pjesor të njësive fetare, të nënshtërimit të tyre ndaj shtetit, përdorimit të këtyre njësive në favor të arritjes së objektivave politikë të diktaturës, deri sa të ishte e mundur, dhe në fund shkatërrimin e tyre. Një proces i tillë ka zgjatur në Shqipëri për mbi 23 vite të përgjakshme, d.m.th. deri në vitin 1967. Pjesa e kohës së mbetur përbën periudhën e përpjekjes për shuarjen totale të besimit fetar, krijimit të një shoqërie pa klasa dhe të adaptimit të “religjionit” të veçantë nacional, të emërtuar në literaturën perëndimore, si shqiptarizëm.² Sidomos, shqiptarët e besimit katolik vuajtën më tepër dhe humbën nëpër ekzekutime, vrasje pa gjyq, tortura, internime dhe kampe pune, e brenda këtij komuniteti dhuna e arriti kulmin e saj kur u ushtrua mbi barinjët e kishës, që ishin njëkohësisht edhe ndër udhëheqësit më të mëdhenj të mendimit shqiptar. Vlerën dhe rolin e klerit katolik shqiptar e gjejmë të shprehur qartë në shkrimin e Prof. Karl Gurakuqit, në një letër drejtuar françeskanit Atë Daniel Gjeçaj. Ky citim i çmuar na ofron një pikëpamje të rrallë dhe të drejtpërdrejtë nga një personalitet i traditës sonë, i cili e njohu personalisht dhe në mënyrë intensive kontributin dhe kalvarin e këtij kleri: “*Po të përshkojmë fletët e historisë të Shqipërisë së kohës jo fort të largët, shofim se nuk pat lëvizje kombëtare, në daç me pendë e në daç edhe tue vue vetën në rrezik në fushën e luftimit, ku frati mos të ketë pasë një pjesë me randësi. Ashte ende i*

¹ Barbara Jelavich, *History of the Balkans: Twentieth Century*, 14th ed., vol. 2 (New York: Cambridge University Press, 1999), f. 378.

² “*L’albanisme est la religion des Albanais*” (Feja e shqiptarit është shqiptaria) ishte një slogan i përdorur shumë prej regjimit. Shih Didier Rance, *Albanie : ils ont voulu tuer dieu : la persécution contre l’Église catholique, (1944-1991)* (Paris : Aide à l’Église en détresse, 1996), f. 94.

freskët gjaku i martirvet françeskanë qi u derdh n'altarin e Atdheut nën plumin e trathtarvet e të mohuesve të traditave shumëvjeçare arbore (autori nënkupton me këtë komunistët shqiptarë - shënim i imi, NL). Mënjë e këtyre renegatave shfroi ma tepër se kërkund, në familjen frenore. U vranë pinjojt ma të mirë e ma të vlefshëm; nuk u kursye asnjë, “pra frati ‘i dhunë kurrkuj s’i a bani ; - nuk bani kende me kja; - për t’keq s’i duel kurr zani ; - për Atme e shejten Fe-punoj me t’drejtë n’ket dhe!” A nuk kishte dijtë At Harapi me u dhanë kambvet e me i u ikë gjakatarvet, sikurse veproji ndonji prej prisavet civile, qi i la shokët në baltë për me shpëtue lëkuren e vet?... Po Palaj, Prendushët, Gjon Shllaku, Ciprijan Nikaj, Pal Dodaj etj. A nuk kishin mujtë me gjetë strehë kudo në ndonji kuvend n’Europën e lirë? Po. Por deshten me e nda të keqen me popullin, pse për popullin kishin punue. Nuk e trathtuen parimin e paracaktuem. Po, pse u pushkatuen? Pse e deshtën Shqipnjin. Ashte me të vertetë rasa me kja me Jeremin profetë: “Albania, Albania, quid feci tibi, aut in quo contristavi te? Respondi nihi!... “U gjykuen si Krishti, pa faj e pa njollë!”³ Për regjimin komunist, Kisha Katolike përfaqësonte një kundërshtar të papranueshëm, jo vetëm në planin filozofik (pra, materializmi kundër spiritualitetit), por edhe atë politik e kulturor, duke qenë se ishte një institucion me orientim perëndimor, në kohën kur Shqipëria e re po lidhte aleanca me botën lindore dhe sllave. Shtypja e veçantë ndaj saj rrënjëzohej edhe me një ksenofobi të thelluar ndaj Perëndimit nga elita udhëheqëse, e cila kishte një formim kulturor të largët nga patriotizmi me orientim evropian që kishte karakterizuar kishën. Në goditjen e tyre kundër Kishës Katolike në Shqipëri, komunistët **shqiptarë në fazën e parë filluan të zbatojnë një propagandë subversive, të nisur në fakt që në periudhën e luftës** (në Konferencën e Labinotit, më 10 korrik 1943, kur Enver Hoxha u caktua komisar politik dhe u ngarkua me detyrën e indoktrinimit të pjesës jokomuniste të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare) në bazë të së cilës edhe klerikët rreshtoheshin në të njëjtën radhë me armiq të Shqipërisë, ku fokusi i veçantë ishte tek Kleri Katolik.⁴ Pas marrjes së pushtetit, në fund të vitit 1944, Partia Komuniste Shqiptare e shfrytëzoi momentin për të materializuar një urrejtje të gjatë e të akumuluar ndaj institucionit katolik, duke e parë atë si pengesë ideologjike dhe kulturore për ndërtimin e rendit të ri. Në emër të “spastrimit të elementeve fashistë” u ndërmor një fushatë e gjerë ndëshkuese kundër klerit katolik, që në fakt kishte si objektiv shkatërrimin e strukturave të tij në shoqëri dhe ndikimin që ai kishte mbi opinionin publik. Në epiqendër të kësaj fushate u vendosën hierarkët e lartë të Kishës, personalitete me autoritet kombëtar dhe me reputacion intelektual e fetar. Ata u goditën me akuza politike të fabrikuara, si “bashkëpunim me pushtuesin” apo “krime lufte”, duke u dënuar në të parat gjyqet speciale të regjimit. Shumë prej tyre u ekzekutuan ose u dënuan me burgime të gjata, ndërsa të tjerë u internuan e më vonë iu nënshtruan një persekutimi sistematik politik dhe ideologjik, që do të zgjaste për dekada.

Momenti i dytë i rëndësishëm i kësaj goditje graduale u ofrua me Ligjin mbi Reformën Agrare, të gushtit të vitit 1945, në bazë të të cilit u goditën pasuritë e institucioneve fetare, kishave dhe manastireve, duke u hequr atyre mundësinë ekonomike të mbijetesës dhe të shërbimeve.⁵ Megjithatë, eliminimi fizik dhe moral i figurave udhëheqëse nuk arriti ta çonte Kishën në

³ Karl Gurakuqi, “Letër drejtuar Atë Daniel Gjeçaj,” në *Letërshkëmbim Në Mërgim, 1944-1958*, vol. I (Palermo, 1957) (dorëshkrim).

⁴ Nertila Haxhia Ljarja, *Kisha Katolike dhe shteti komunist në Shqipëri* (Lezhë: Enti Botues “Gjergj Fishta,” 2012), f. 256.

⁵ Po aty.

nënshtrim të plotë. Përkundrazi, ajo shfaq formë të hapura opozitarizmi moral ndaj politikave të regjimit, sidomos ndaj reformave ekonomike dhe shpronësimeve të pronave private. Në thelb, qëndrimi i Kishës nuk ishte një kundërvënie ideologjike ndaj komunizmit, por një reagim në mbrojtje të parimeve themelore të të drejtave të njeriut dhe ato të pronës private, të cilat ajo i konsideronte si pjesë të pandashme të natyrës së dinjitetit njerëzor. Në mungesë të një opozite politike ligjore, Kisha Katolike u bë një zë i pavarur kritik në mbrojtje të moralit shoqëror dhe të lirive themelore. Kjo qëndresë paqësore u interpretua nga pushteti si sabotim politik dhe si “bashkëpunim me armikun”. Propaganda komuniste e instrumentalizoi këtë transparencë, për të intensifikuar akuzat dhe për të legjitimuar goditjet e mëtejshme. Në dokumentet zyrtare të kohës klerikët përshkruheshin si agjentë të propagandës fetare, që gjatë meshave “predikonin se toka është e Zotit” apo “se nuk lejohet të merret djersa e tjetrit”; mesazhe morale që regjimi i interpretonte si sfida ndaj ideologjisë komuniste.

Momenti i tretë ka të bëjë me ndërprerjen e mbështetjes qeveritare për komunitetet fetare dhe veprimtaritë e tyre sociale, përfshirë edukimin dhe mbylljen graduale të qendrave të arsimit të drejtuar nga kleri.⁶ Ky hap shënoi një nga etapat më të rëndësishme në procesin e marginalizimit të institucioneve fetare nga jeta publike, duke synuar t’i shkëputte ato nga baza e tyre tradicionale dhe ndikimi në shoqëri. Qeveria komuniste, e cila në vitet e para të pasluftës kërkonte të projektonte imazhin e një shteti reformues dhe unifikues, filloi gradualisht të izolonte kishat, xhamitë dhe institucionet fetare nga funksionet e tyre historike në fushën e arsimit, bamirësisë dhe kujdesit social. Ndihamat shtetërore, që më parë shkonin për mirëmbajtjen e institucioneve arsimore dhe filantropike të drejtuar nga kleri, u ndërprejnë plotësisht. Në mënyrë të veçantë, më rëndë u godit Kisha Katolike, e cila kishte krijuar përpara luftës një rrjet të gjerë shkollash, konviktesh dhe institucioneve edukative. Shkollat françeskane, jezuite dhe urdhrat e tjerë mësimorë, të njohur për nivelin e lartë arsimor dhe për kontributin në formimin qytetar e kulturor të brezave të rinj, u mbyllën ose u shtetëzuan, duke kaluar nën kontrollin ideologjik të Ministrisë së Arsimit. Ky proces u justifikua nga regjimi si pjesë e “*reformimit të arsimit*” dhe e ndarjes midis shtetit laik dhe fesë, por në thelb synonte eliminimin e çdo ndikimi fetar në edukimin e rinisë dhe shkatërrimin e modelit të vjetër moral e qytetar që përfaqësonte kleri. Mbyllja e institucioneve arsimore fetare u shoqërua me ndalimin e mësimave të fesë, konfiskimin e bibliotekave dhe arkivave kishtarë, si dhe ndjekjen penale të klerikëve që orvateshin ta vazhdonin në mënyrë të pavarur veprimtarinë e tyre edukative. Në këtë mënyrë, ndërprerja e mbështetjes qeveritare dhe mbyllja graduale e qendrave arsimore të drejtuar nga kleri përbënin një fazë të rëndësishme të politikës shtetërore të ateizimit, ku goditja ndaj fesë realizohej jo vetëm përmes dhunës politike, por edhe përmes izolimit ekonomik, arsimor dhe kulturor të institucioneve fetare, nga shoqëria.

Momenti i katërt, ka të bëjë me asgjësimin fizik të udhëheqësisë së klerit katolik. Tërbimi komunist në fillimet e veta u drejtua më së shumti kundër udhëheqësisë së Kishës sesa kundër pasuesve të tyre.⁷ Kështu, pas vitit 1948, udhëheqja komuniste e partisë që tashmë ishte pagëzuar

⁶ Haxhia Ljarja, *Kisha Katolike dhe shteti komunist në Shqipëri (1944-1990)*, f. 256.

⁷ Po aty.

me emrin e ri Partia e Punës e Shqipërisë (PPSH), vendosi që lufta kundër Kishës Katolike të institucionalizohej. Kjo periudhë shënoi kalimin nga një ndëshkim spontan, në një strategji të planifikuar të shtypjes shtetërore, e shoqëruar me masa ligjore, propagandistike dhe policore. Në të njëjtën kohë, pas prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë dhe afrimin me Bashkimin Sovjetik, regjimi e shfrytëzoi situatën për të forcuar kontrollin mbi jetën fetare dhe për ta nënshtruar përfundimisht Kishën Katolike shqiptare ndaj ideologjisë ateiste të shtetit. Duke filluar me eliminimin e elitave intelektuale dhe atdhetare, regjimi synoi të zhdukte bazën më të shkolluar të shoqërisë, për ta bërë më të lehtë gjunjëzimin e Kishës. Sidoqoftë, rezistenca e klerit katolik nuk mori formën e një opozite të hapur dhe të organizuar, por të një opozite të heshtur dhe natyrale, e detyruar nga mungesa e plotë e hapësirës demokratike, që ishte rrjedhojë e represionit të ashpër. Një tipar dallues i strategjisë së regjimit ishte shtypja e diferencuar brenda Kishës Katolike. Duke ndjekur një strategji të njohur në luftën kundër katolicizmit, goditja më e ashpër u drejtua fillimisht kundër Etërve Jezuitë, të njohur për influencën e tyre intelektuale. Më pas, goditja u kthye kundër Etërve Françeskanë, të konsideruar si kudhër e “shqiptarizmit” dhe e identitetit kombëtar, për të përfunduar me një persekutim të përgjithshëm kundër të gjithë anëtarëve të klerit. Në një fazë të re të shtypjes, ndërmjet viteve 1949-1951, regjimi komunist synoi ta “legalizonte” nënshtrimin e fesë, përmes miratimit të ligjeve të reja. Pasi kishte spastruar udhëheqjen më të “rrezikshme” klerikale, qëllimi ishte që të forconte kontrollin e shtetit mbi jetën e brendshme të komuniteteve fetare, të monitoronte zgjedhjet e tyre dhe, më e rëndësishmja, ta shkëputte Kishën Katolike Shqiptare nga Vatikani, duke e veçuar veprimtarinë fetare vetëm brenda vendit. Më gjithë terrorin dhe shkatërrimin e institucioneve që formonin brezin e ri, kleri katolik, ndryshe nga bashkësitë e tjera fetare, i kundërshtoi hapur këto ligje, duke refuzuar veçanërisht heqjen e kompetencave të Papës dhe shkëputjen nga Selia e Shenjtë. Ky kundërshtim e vuri Kishën dhe Shtetin në një konflikt të hapur, por të ndjeshëm, pasi regjimi frikësohej nga pakënaqësia e përhapur në masën e besimtarëve. Konflikti çoi në bisedime të nivelit të lartë midis përfaqësuesve të shtetit (Mehmet Shehut) dhe të klerit (Dom Bernardin Shllakut). Shteti, përmes kërcënimeve dhe premtimeve të rreme (duke e ndarë lidhjen “politike” nga ajo “shpirtërore”), e detyroi Kishën të nënshkruante një “kompromis” që në fakt ishte një imponim i njëanshëm. Nënshkrimi nga ana e klerit u bë me anë të detyrimit dhe nga frika e një persekutimi edhe më të madh, por edhe nga shpresa e dobët se premtimet verbale do të respektoheshin. Ky akt simbolizon fitoren e regjimit në një nga betejat më kritike për kontrollin absolut. Tashmë, përfundimisht, organizmat fetare iu nënshtruan shtetit dhe, si pasojë, veprimi politik ndaj klerit ishte më i zbutur në këtë periudhë. Shumë klerikë dolën nga burgu dhe filluan përsëri jetën e tyre fetare. Pas nënshkrimit të Statutit, në fillimin e viteve 1950, shteti fillimisht u tregua i gatshëm në subvencionimin e tij ekonomik ndaj Kishës dhe krijoi një zyrë të veçantë për çështjet fetare. Populli ishte më i lirë në ndjekjen e ceremonive fetare, por gjithçka ishte sa për fasadë, pasi çdo gjë kontrollohej nga Sigurimi i Shtetit. Në fillim të viteve 1960 regjimi komunist e intensifikoi luftën e tij në “frontin ideologjik”, me qëllimin për të krijuar “njeriun e ri socialist”, të pastër nga çdo ide e huaj, veçanërisht nga feja. Për ta bërë këtë, ai përdori një mjedis të favorshëm; një shoqëri të mbyllur, të izoluar dhe me nivel të ulët zhvillimi. Për t’i dhënë një mbulesë ligjore këtij

sulmi të ri, në vitin 1963 u miratua një ligj ri që i dha shtetit të drejtën absolute për të “njohur” ose jo komunitetet fetare, si dhe për të kontrolluar çdo veprimtari të tyre. Ky ligj hapi rrugën për fazën përfundimtare: Revolucionin Ideologjik dhe Kulturor. I nxitur nga fjalimi programatik i Enver Hoxhës, në shkurt 1967, regjimi nisi një fushatë të hapur dhe të dhunshme kundër të gjitha simboleve fetare. Nën nxitjen e Partisë, grupe të organizuara, veçanërisht të rinj, sulmuan fizikisht dhe profanuan ndërtesat fetare, duke shkatërruar ose konfiskuar objektet e kultit edhe nëpër shtëpi private. Në fund të vitit 1967 regjimi shpalli me krenari se kishte arritur qëllimin: Shqipëria ishte bërë “shteti i parë ateist në botë”, duke shënuar kulmin e një persekutimi sistematik që zgjati dekada. Megjithëse Revolucioni Ideologjik dhe Kulturor i ndërmarrë në fund të viteve 1960 synonte të përmbyllte procesin e çrrënjësjes së besimit fetar në Shqipëri, lufta e regjimit komunist kundër fesë nuk përfundoi me të. Përkundrazi, ajo mori forma të reja dhe më të ashpra, gjatë viteve pasuese. Gjyqet politike ndaj klerikëve, të cilët në mënyrë të fshehtë vijonin praktikimin e riteve fetare, apo ruajtjen e objekteve të kultit, u shndërruan në një instrument represioni sistematik. Këta klerikë akuzoheshin për “veprimtari armiqësorë” dhe dënoheshin me burgime të gjata, ose me internime në zona të thella të vendit. Kjo fazë e re e konfrontimit ndërmjet shtetit dhe institucioneve fetare e arriti kulmin me miratimin e Kushtetutës së Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, në vitin 1976. Neni 37 i saj sanksiononte qartë se *“Shteti nuk njeh asnjë fe dhe mbështet propagandën ateiste me qëllim të rrënjësjes së botëkuptimit materialist-shkencor tek njerëzit”*. Ky formulim përbënte jo vetëm ndalim të fesë në aspektin institucional, por edhe legjitimitimin kushtetues të ateizmit shtetëror, duke e shpallur Shqipërinë të parin vend zyrtarisht ateist në botë. Megjithatë, objektivat ideologjike të udhëheqjes komuniste nuk u realizuan plotësisht. Pavarësisht rrënimit të plotë të institucioneve fetare, shembjes së kishave dhe xhamive, si dhe burgosjes ose eliminimit fizik të pjesës më të madhe të klerit, ndjenja fetare nuk u shua në ndërgjegjen e besimtarëve shqiptarë. Sidomos në komunitetin katolik, besimi u ruajt si një formë e rezistencës shpirtërore dhe identitare, duke u ushtruar fshehtas në mjedisin familjar. Kjo dëshmon se edhe në kushtet e terrorit ideologjik e shtetëror feja mbeti një komponent i qëndrueshëm i kulturës dhe i vetëdijes shpirtërore të shqiptarëve. Në pranverën e vitit 1990 Shqipëria filloi të tregojë shenjat e para të ndryshimit, nën presionin e shndërrimeve gjeopolitike në Evropën Lindore. Vizita e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Javier Perez de Kueljar, dhe ankesat e tij për të drejtat e njeriut, përkuan me miratimin nga Kuvendi Popullor i disa reformave, ku përfshihej edhe e drejta e lirisë fetare. Ky ishte një proces i kontrolluar “nga lart”, nga vetë kasta drejtuese komuniste, që synonte një hapje të ngadaltë dhe të komanduar. Megjithëse ndryshimet politike të fundviteve 1980 dhe fillimit të viteve 1990 u perceptuan fillimisht si një proces i kontrolluar nga pushteti, në aspektin e lirisë fetare ato dolën përtej çdo parashikimi zyrtar. Ngjarjet e 4 dhe 11 nëntorit 1990 në Shkodër, të organizuara nga komuniteti katolik, - që për dekada me radhë kishte qenë viktimë e persekutuar më ashpër nga aparati shtetëror, - përbënin një moment historik dhe revolucionar. Ato shënuan jo vetëm ringjalljen e jetës fetare, por edhe shpërthimin e një lëvizje të brendshme shoqërore, që vinte në dyshim vetë legjitimitetin e rendit politik ekzistues. Këto ngjarje dëshmuar se kërkesa për liri dhe besimi nuk ishte një produkt i presioneve të jashtme apo i reformave të diktuar “nga lart”,

por një nevojë e thellë shpirtërore dhe identitare, e cila kishte mbijetuar përmes terrorit ideologjik e politik të regjimit. Në këtë kuptim, veprimi i komunitetit katolik në Shkodër nuk ishte thjesht një akt fetar, por një manifestim i dëshirës për ndryshim demokratik, një nismë që mund të kishte shërbyer si model për tranzicionin e ardhshëm politik dhe shoqëror të vendit, sikur dinamika “nga poshtë” të ishte përqafuar më gjerësisht. Goditja që Kisha Katolike kishte pësuar gjatë dekadave të regjimit ishte aq e thellë, saqë, edhe pse ajo arriti të rishfaqej në vitin 1991, me një strukturë minimale organizative, përfaqësonte vetëm një hije të zbehtë të fuqisë së saj institucionale, intelektuale dhe kulturore të vitit 1944. Dëmet ishin të pariparueshme në shumë aspekte: u shkatërruan institucione arsimore, u zhdukën elita të tëra klerikësh dhe humbën kapacitete intelektuale që kishin ushqyer mendimin kritik dhe edukimin kombëtar. Rivendosja e plotë e rolit dhe e autoritetit të Kishës Katolike në jetën shpirtërore dhe kulturore të Shqipërisë kërkon një proces afatgjatë të rindërtimit moral e institucional. Siç ka vënë në dukje Milovan Gjilas, njëra prej figurave më të njohura të lëvizjes komuniste jugosllave, “*Njerëzit do të habiten nga këto aventura të mëdha të kryera nga ajo (Partia Komuniste), dhe do të turpërohen nga mjetet që u përdorën për t’i përmbushur ato*”.⁸ Kjo thënie shërben si një reflektim i thellë për mënyrën sesi pushteti totalitar, në përpjekjen për të krijuar “njeriun e ri”, shkatërroi rrënjët shpirtërore dhe kulturore të vetë shoqërisë që pretendonte ta emanciponte. Në përfundim, historia e raportit midis Kishës Katolike dhe shtetit komunist në Shqipëri përbën një nga dëshmitë më të qarta të rezistencës shpirtërore dhe morale të shqiptarëve ndaj dhunës ideologjike. Ajo tregon se besimi dhe ndërgjegjja fetare mbeten ndër forcat më të **qëndrueshme të identitetit kombëtar dhe të aspiratës njerëzore për liri**, megjithëse mund të burgosen trupat dhe të shkatërrohen institucionet.

Konkluzione dhe vëzhgime kryesore

a) Persekutimi i klerit dhe i Kishës Katolike ishte sistematik dhe i planifikuar.

- Regjimi totalitar komunist i Enver Hoxhës nuk e goditi klerin vetëm për arsye ideologjike; ai përdori dhunën, ligjet represive, propagandën dhe kontrollin ekonomik, për të shkatërruar plotësisht ndikimin e tij në shoqëri”.
- Ky persekutim nuk ishte i njëjtë në të gjitha bashkësitë fetare: kleri katolik, duke qenë i lidhur me traditën evropiane dhe intelektin e popullit, u vu në shënjestrën më të ashpër.

b) Kisha Katolike si mburojë morale dhe shoqërore.

- Klerikët nuk e kundërshtonin komunizmin ideologjik thjesht për inat; rezistenca e tyre ishte mbrojtje e moralit shoqëror, të drejtave të njeriut dhe e pronës private.
- Kjo e bëri Kishën një institucion që rrezikonte drejtpërdrejt rendin e ri, prandaj persekutimi ishte i detajuar dhe i vazhdueshëm.

c) Goditja ndaj institucioneve arsimore dhe kulturore.

- Shkollat dhe konviktet fetare u mbyllën, bibliotekat u konfiskuan dhe aktiviteti arsimor u centralizua nën ideologjinë komuniste.

⁸ Gjon Sinishta, *The Fulfilled Promise: A Documentary Account of Religious Persecution in Albania* (Santa Clara, Ca.: H & F Composing Service, 1976), f. 28.

- Humbja e elitës klerikale dhe e institucioneve, krijoi një boshllëk në kulturën dhe intelektin shqiptar, që zgjati dekada.

d) Rezistenca shpirtërore e besimtarëve.

- Edhe pas dekadash persekutimi, besimi nuk u shua; ai u ushtrua fshehtas brenda familjeve dhe komuniteteve, duke treguar që identiteti shpirtëror dhe fetar nuk mund të fshihet lehtë.
- Ngjarjet e vitit 1990 në Shkodër treguan se bashkësia katolik e ruante aftësinë për t'u organizuar dhe për të kërkuar lirinë.

e) Persekutimi dhe kontrolli totalitar nxitën arratisjet.

- Dhuna, burgosjet dhe izolimi ideologjik krijuan një presion të jashtëzakonshëm psikologjik dhe fizik.
- Arratisjet e shqiptarëve në periudhën midis viteve 1940-1980 lidhen drejtpërdrejt me këtë situatë: shumë qytetarë kërkonin të shpëtonin nga persekutimi politik, ekonomik dhe fetar, duke e parë emigrimin si një mënyrë për të mbrojtur jetën dhe besimin e tyre.
- Klerikët, intelektualët dhe të rinjtë u bënë një pjesë e dukshme e valëve të arratisjeve, shpesh në mënyrë të rrezikshme, përmes maleve, detit ose duke përdorur rrugë të fshehta nëpër kufij.
- Arratisjet shqiptare gjatë periudhës komuniste nuk mund të kuptohen vetëm si kërkesë për liri fizike, por edhe si një reagim ndaj “*shtypjes kulturore dhe fetare*”.
- Për qytetarët katolikë, në veçanti, emigrimi shpesh ishte mënyra e vetme për të mbrojtur besimin, edukimin dhe identitetin shpirtëror të familjeve të tyre.
- Çdo tentativë për të shpëtuar nga regjimi ishte një akt i guximshëm individual dhe kolektiv, që lidhej ngushtë me përvojën e vuajtjes së Kishës dhe klerit.
- Edhe në kushtet më ekstreme të terrorit ideologjik, identiteti shpirtëror e nacional mbijetoi dhe u shndërrua në një forcë të brendshme, që nxiti ndryshime shoqërore dhe politike.
- Arratisjet nuk ishin vetëm akt i mbijetesës, por edhe një shprehje e dëshirës për liri dhe për ruajtjen e një mënyre jetese që regjimi dëshironte ta shkatërronte.

Bibliografia

1. Gurakuqi, Karl. “Letër drejtuar Atë Daniel Gjeçaj.” Në *Letërshkëmbim në Mërgim, 1944-1958*, Vol. I. Palermo, 1957.
2. Haxhia Ljarja, Nertila. *Kisha katolike dhe shteti komunist në Shqipëri (1944-1990)*. Lezhë: Enti Botues “Gjergj Fishta,” 2012.
3. Jelavich, Barbara. *History of the Balkans: Twentieth Century*. 14th ed. Vol. 2. New York: Cambridge University Press, 1999.
4. Rance, Didier. *Albanie : ils ont voulu tuer dieu : la persécution contre l'Église catholique, (1944-1991)*. Paris: Aide à l'Église en détresse, 1996.
5. Sinishta, Gjon. *The Fulfilled Promise: A Documentary Account of Religious Persecution in Albania*. Santa Clara, Ca.: H & F Composing Service, 1976.